



Prishtinë, 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3283_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2969_04_26** i datës 29.04.2026;
- Kundërshtimi i KESCO-s i dt. 08.06.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, lidhur me konsumatorin **B. S.**, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me nr. ZRRE/DMK_V_2969_04_26 i datës 29.04.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me datë 29.04.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2969_04_26 me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit B. S., me shifër DFE - 2001525 dhe e ka obliguar KESCO-n, që konsumatorit t'i anuloj korrigjimin financiar të dt. 09.09.2025, dhe për periudhën kohore prej 01-07/2025, ta korrigjoj në vlerë financiare prej - **42.85 €**.

Të pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRe-së, për këto shkaqe:

- Shpenzimi i regjistruar në njehsorin elektrik me nr. 32597929 është i saktë dhe mos faturimi me rregull i konsumatorit, nuk nënkupton matje jo të saktë të shpenzimit të tij;
- Korrigjimi i kontestuar, është i mbështetur në gjendjet e regjistruara në njehsorin elektrik, sepse njehsori është SMART dhe e bën ruajtjen e të dhënave;
- Çdo shpërndarje tjetër e këtyre kWh, në mënyrë proporcionale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kërkojnë pezullimin e vendimit të DMK-së;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të dt. 08.06.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 29.04.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 29.09.2025, Transaksionet e konsumatorit me shifër DPR – 90093766, Rrjedhën e energjisë elektrike, Listat e leximit dhe Korrigjimin Financiar të dt. 09.09.2025, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Bordi i ka analizuar me kujdes edhe Listat e Leximit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Transaksionet dhe ka gjetur se, konsumatori është lexuar dhe është faturuar me rregull, dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në pikën matëse të tij. Për më tepër, konsumatori e ka të vendosur njehsorin e llojit SMART dhe lexohet nga distanca. Gjithsesi, në periudha të caktuara kohore, DMK ka gjetur se, konsumatori është lexuar dhe faturuar me CCP – pa matje.

Bordi po ashtu e ka analizuar me kujdes dhe Korrigjimin Financiar të dt. 09.09.2025, në të cilin ndër të tjera është evidentuar si në vijim: *“Faturim i vlerësuar, shpërndarje e kWh per periudhën 01-07/2-25, duke u bazuar në leximet AMR dhe Rrjedhën e Energjisë Elektrike”*. Pas analizimit me kujdes të këtij korrigjimi, konstatohet se, KESCO ka vepruar në harmoni me nenin 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si në vijim: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*, por që, pas rivlerësimit nga DMK si shkallë e parë në ZRrE, korrigjimi financiar që i takon konsumatorit, për periudhën kohore 01-07/2025, rezulton të jetë **-42.85 €**.

Përgjatë krahasimit të shpenzimeve të tij, Bordi ka gjetur se, mesatarja e shpenzimeve të konsumatorit për periudhën 01/2024 – 07/2024, është **671.82 kWh/muaj**. Po ashtu, edhe për vitin aktual, mesatarja e shpenzimeve të konsumatorit për periudhën 01/2025 – 07/2026 është **870.41 kWh**. Dhe një vit më herët, mesatarja e shpenzimeve të konsumatorit është rreth **854.23 kWh/muaj**. Nga ky krahasim, Bordi konstaton se, konsumi i konsumatorit, në periudha të ngjashme të vitit është relativisht i përafërt dhe nuk ka dallime të theksuara.

Bordi thekson se, Furnizuesi KESCO ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 – Faturimi të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ashtu që, *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”*.

Duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si në vijim: *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e*



energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuar nga KESCO si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **B. S.**
- Arkivit të ZRrE-së